



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 04.07.2023
Nr. Prot 6187

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. Projektvendim "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë, që do të zhvillohen më datë 23 Korrik 2023".
2. Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve".

Miratimi i këtyre projektvendimeve është kompetencë e Komisionit Rregullator. Për këtë arsye propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacionit shoqërues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

